# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6221
E shtunë, 23 janar 2021
çmimi 0.40


## Brenda 24 orëve, 14 të vdekur nga Covidi në Kosovë

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA MBAJTUR TË PREMTEN MBLEDHJEN E RADHËS FAQE 4-5

# KQZ-ja NUK CERTIFIKON LISTAT ZGJEDHORE TË LV-së, NISMËS DHE AAK-së



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka certifikuar të premten listat zgjedhore të subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje, Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, pavarësisht se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim i rekomandoi KQZ-së që t'i certifikojë të gjithë kandidatët për deputetë, të cilët janë në kuadër të listave zgjedhore të subjekteve politike. Shumica e anëtarëve të KQZ-së vendosën që të votojnë një nga një për subjektet politike, pasi disa prej tyre nuk i kishin zëvendësuar kandidatët për të cilët Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) kishte thënë se nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Subjektet politike dhe kandidatët që vlerësojnë se pa të drejtë nuk janë certifikuar, kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orësh në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Çështja mund të shkojë deri në Gjykatën Supreme nëse pala mund të jetë e pakënaqur me vendimin e PZAP-së

## AKTUALE



**BIDENI NËNSHKRUAN DHJETË URDHRA EKZEKUTIVË PËR TRAJTIMIN E PANDEMISË** F. 2

**SHËNOHET PËRVJETORI I SULMIT TË DYTË NDAJ FAMILJES JASHARI** F. 10

**HEDHET POSHTË KALLËZIMI PENAL NDAJ DREJTORIT TË URBANIZMIT NË PRIZREN** F. 6

## SELIMI: VEPRIMET E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA PO PRODHOJNË EFEKT POLITIK



Ministri në detyrë i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se vlerat e shtetit të Kosovës kanë dalë nga lufta e UÇK-së, duke potencuar se Kosova duhet të bëjë më shumë në aspektin e kujtesës kolektive. Selimi ka thënë se veprimet e Dhomave të Specializuara kanë dalë nga veprimi juridik dhe, sipas tij, kanë prodhuar efekte politike FAQE 3

## EKONOMI

**HUMBJET E BIZNESEVE, TË PALLOGARITSHME** F. 9

**FATURAT E ENERGJISË ELEKTRIKE DERI NË MAJ DO T'JU VIJNË MË LIRË** F. 8



## TË PUNËSUARIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DO TA MARRIN EDHE PAGËN E 13 FAQE 7



## SPORT

**SOT DY DERBI NË SUPERLIGË** F. 12

**MKRS-ja LICENCON FEDERATËN E GOLFIT** F. 12



RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhep isht Tetov' Gur'z-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Bideni nënshkruan dhjetë urdhra ekzekutivë për trajtimin e pandemisë



UASHINGTON, 22 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, nënshkroi një mori urdhrash ekzekutivë derisa shpalosi një strategji kombëtare kundër pandemisë së tërbuar të koronavirusit. Dhjetë urdhrat, mes të tjerash, synojnë t'i japin hov programit të vaksinimit, ta zgjerojnë testimin dhe veshjen e maskave, si dhe ta rrisin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave që do të ndihmonin për krijimin e politikave. Udhëtarët nga jashtë do të duhet të kenë test negativ kundër koronavirusit dhe të futen në karantinë pas mbërritjes në ShBA.

Bideni, po ashtu, i udhëzoi agjencitë ta përdorin Aktin e Prodhimit të Mbrojtjes, një kompetencë kjo e kohës së luftës, që e lejon qeverinë ta udhëzojë industrinë për të prodhuar furnizime të nevojshme në kohë të emergjencës kombëtare. "Kjo është një ndërmarrje e kohës së luftës. Plani ynë nis me një fushatë agresive, të sigurt dhe efektive të vaksinimit, që synon përmbushjen e qëllimit tonë për administrimin e 100 milionë dozave në 100 ditët tona të para në zyrë", ka thënë Bideni derisa nënshkroi urdhrat në Shtëpinë e Bardhë. Bideni e ka bërë luftën kundër koronavirusit prioritetin e tij kryesor. Ndryshe nga paraardhësi i tij, Donald Trump, Bideni planifikon të ketë strategji kombëtare, me përfshirje më të madhe të qeverisë federale, e jo t'ua lë shteteve veç e veç të vendosin se çfarë është më mirë.

Bideni i zvogëloi pritjet, duke thënë se situata ka të ngjarë të përkeqësohet përpara se të përmirësohet. Ai tha se numri i viktimave në ShBA mund ta kalojë 500 000-shin muajin e ardhshëm. Këtë javë kaloi mbi 400 000. Bideni tha se më shumë amerikanë kanë vdekur tashmë në pandemi sesa gjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse qeveria amerikane, deri më tani, ka dërguar rreth 38 milionë doza të vaksinave të miratuara në shtete, vetëm 17.5 milionë prej tyre janë dhënë, kanë bërë me dije Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.

Bideni, po ashtu, premtoi se do të jetë transparent dhe se do t'i lejojë shkencëtarët të punojnë të lirë nga ndërhyrjet politike. "Jam i bindur se populli amerikan është i gatshëm të mos kursejë asnjë përpjekje për ta kryer këtë. Ne mund ta bëjmë këtë nëse jemi bashkë", ka deklaruar Bideni.

Administrata Trump është kritikuar për mungesë strategjie në nivel federal. Shtetet e Bashkuara janë vendi më i prekur në botë nga koronavirusi, me mbi 24.6 milionë të infektuar dhe mbi 410 000 viktima.

# Republikanët kërkojnë shtyrjen e gjykimit të Trumpit deri në shkurt



UASHINGTON, 22 JANAR - Republikanët në Senatin e Shteteve të Bashkuara u kërkuan demokratëve ta shtyjnë fillimin e gjyqit të ish-presidentit Donald Trump deri në shkurt. Ata thanë se kjo do t'i jepte kohë Trumpit për ta përgatitur mbrojtjen.

Trumpi akuzohet për nxitje të kryengritjes, pasi mbështetësit e tij sulmuan ndërtesën e Kongresit Amerikan më 6 janar, në përpjekje për ta përmbysur rezultatin e zgjedhjeve.

Pesë persona, përfshirë një zyrtar të policisë, mbetën të vrarë në dhunë.

Dhoma e Përfaqësuesve ka votuar për fajësimin e Trumpit. Ajo tani duhet t'i çojë akuzat te Senati, i cili e ka fjalën përfundimtare.

Edhe pse demokratët tani kontrollojnë Senatin, atyre do t'u duhet mbështetja e së paku 17 republikanëve për ta dënuar Trumpin, përkatësisht dy të tretat e votave të senatorëve. Trumpi ka shkuar në Florida, pasi mandati i tij ka përfunduar të mërkurën. Udhëheqësi i republikanëve në Senat, Mitch McConnell, tha se "republikanët e Senatit janë të bashkuar fuqimisht pas parimit se institucioni i Senatit, Zyra e Presidencës dhe vetë ish-presidenti Trump meritojnë një proces të plotë dhe të drejtë, që i respekton të drejtat e tij dhe çështjet serioze faktike, ligjore dhe kushtetuese".

Dhoma e Përfaqësuesve ka votuar për shkarkimin e Trumpit më 13 janar, por gjykimi në Senat nuk ka mundur të zhvillohet përpara përfundimit të mandatit të tij më 20 janar. Gjykimi mund të zhvillohet tani, edhe pse Trumpit i ka përfunduar mandati, dhe senatorët mund të votojnë për ta ndaluar atë që të mbajë sërish poste publike. Udhëheqësi i shumicës demokrate në Senat, Chuck Schumer, duhet të pajtohet me idenë e shtyrjes së gjykimit deri në shkurt.

## BE-ja miraton përdorimin e testeve të shpejta antigjenike



BRUKSEL, 22 JANAR - Shtetet anëtare të BE-së miratuan të premten me unanimitet një rekomandim të Këshillit Evropian për të vendosur një kuadër të përbashkët për përdorimin e testeve antigjenike të shpejta dhe njohjen e përbashkët të rezultateve të testeve Covid-19 në të gjithë Bashkimin Evropian. Bëhet fjalë për një mjet qendror për të ndihmuar në zbutjen e përhapjes së virusit dhe për të kontribuar për mirëfunksionimin e tregut të brendshëm.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Selimi: Veprimet e Dhomave të Specializuara po prodhojnë efekt politik

Ministri në detyrë i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se vlerat e shtetit të Kosovës kanë dalë nga lufta e UÇK-së, duke potencuar se Kosova duhet të bëjë më shumë në aspektin e kujtesës kolektive. Selimi ka thënë se veprimet e Dhomave të Specializuara kanë dalë nga veprimi juridik dhe, sipas tij, kanë prodhuar efekte politike



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 JANAR - Ministri në detyrë i Drejtësisë, Selim Selimi, të premten ka marrë pjesë në takimin virtual të organizuar nga Kosovo 2.0, me ç'rast ka folur për bazën ligjore që rregullon mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencialë në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, që është hartuar nga Ministria e Drejtësisë. "Në zbatim të Ligjit nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar potencialë në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, Ministria e Drejtësisë ka miratuar aktet nënligjore", ka bërë me dije Selimi.

Me këtë rast, Selimi ka përmendur Udhëzimin Administrativ për Mbështetjen e nevojshme financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara; Udhëzimin Administrativ për Mbrojtjen juridike të personave të akuzuar potencialë për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, i cili më pastaj është ndryshuar dhe plotësuar, si dhe Udhëzimin Administrativ për Kompensimin e personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, të shpallur të pafajshëm.

Ministri në detyrë, Selimi, ka treguar, po ashtu, se me dispozita është përcaktuar edhe mbështetja e nevojshme financiare për anëtarët e ngushtë të familjes së personave të akuzuar potencialë për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara. "Në këtë drejtim, njësia përkatëse në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe komisioni do t'i shqyrtojnë kërkesat për mbështetjen e nevojshme financiare si ato të personave të akuzuar, po ashtu edhe kërkesat e anëtarëve të ngushtë të familjes së personave të akuzuar për mbulimin e shpenzimeve të ndërlidhura me udhëtimet e tyre kur procedurat gjyqësore zhvillohen jashtë Kosovës dhe do ta ofrojë mbështetjen e nevojshme financiare në këtë drejtim në pajtim me legjislacionin në fuqi", ka theksuar Selimi.

Ministri Selimi tha se vlerat e shtetit të Kosovës kanë dalë nga lufta e UÇK-së. Po ashtu, ai potencoi se Kosova duhet të bëjë më shumë në aspektin e kujtesës kolektive. "Vlerat tona si shtet kanë dalë nga lufta e UÇK-së. Pjesa e drejtësisë nuk i takon ekzekutivit dhe nuk duhet t'i takojë asnjëherë, por kjo iu takon organeve të drejtësisë. Ne çalojmë në disa pjesë, por mund të them se në reparacion qëndrojmë mirë. Kujtesa kolektive duhet përmirësuar. Nuk kemi shumë hapësirë për eufori, sepse prapë kemi të bëjmë me shtetin të cilin kemi pasur luftë dhe i cili na ka sjellë shumë pengesa", është shprehur Selimi.

Ai ka thënë se veprimet e Dhomave të Specializuara kanë dalë nga veprimi juridik dhe, sipas tij, kanë prodhuar efekte politike. "Së pari duhet të besojmë në drejtësi, sepse ajo është në anën tonë. Por një gjë duhet ditur, lëshimi i deklaratave nga ana e Prokurorisë ka qenë dhe mbetet veprim puro politik. Ajo deklaratë nuk është praktikë e drejtësisë sepse elementet që i ka pasur ajo deklaratë kanë qenë politike. Mandej edhe përdorimi i forcës ka qenë joproporcional. Policia e EULEX-it ka përdorur forcë joproporcionale dhe nuk është pritur aspak mirë nga shoqëria sepse ne jo shumë vonë kemi kaluar nga një situatë e tillë, që për neve ngreh paralele nga e kaluara e afërt. Ai përdorim i forcës ka qenë eksesiv. Andaj kjo mua personalisht më bën të mendoj që Dhomat e Specializuara kanë veprime politike dhe kanë anime", ka thënë Selimi.

Në këtë takim morën pjesë edhe Natasha Kandiq, aktiviste e të drejtave të njeriut dhe Donika Emini, udhëheqëse e Platformës CiviKos.

# Hoxhaj në Ferizaj: Rritje e pagave deri në 30 për qind për mjekët



Ferizaj, 22 janar - Kandidati për kryeministër nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se në qeverisjen e tij për një familje do të ketë nga një mjek dhe do të jepen barnat falas. Në një shkrim publikuar në "Facebook", Hoxhaj ka thënë se me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, PDK-ja në qeveri do të sigurojë 580 lloje të barnave për personat me sëmundje kronike.

Hoxhaj, gjithashtu, shkroi se menaxhmenti i Spitalit të Ferizajt dhe i Qendrës Kryesore i Mjekësisë Familjare e mirëpritën planin e PDK-së për rimëkëmbje, me të cilin tha se parashihet edhe rritja e pagave 30 për qind për mjekët dhe sigurimin shëndetësor.




KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) KA MBAJTUR TË PREMTEN MBLEDHJEN E RADHËS

# KQZ-ja nuk certifikon listat zgjedhore të LV-së, Nismës dhe AAK-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka certifikuar të premten listat zgjedhore të subjekteve politike Lëvizja Vetëvendosje, Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, pavarësisht se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim i rekomandoi KQZ-së që t'i certifikojë të gjithë kandidatët për deputetë, të cilët janë në kuadër të listave zgjedhore të subjekteve politike. Shumica e anëtarëve të KQZ-së vendosën që të votojnë një nga një për subjektet politike, pasi disa prej tyre nuk i kishin zëvëndësuar kandidatët për të cilët Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) kishte thënë se nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Subjektet politike dhe kandidatët që vlerësojnë se pa të drejtë nuk janë certifikuar, kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orësh në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Çështja mund të shkojë deri në Gjykatën Supreme nëse pala mund të jetë e pakënaqur me vendimin e PZAP-së

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka certifikuar të premten listat zgjedhore të subjekteve politike: Lëvizja Vetëvendosje, Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim i rekomandoi KQZ-së që t'i certifikojë të gjithë kandidatët për deputetë, të cilët janë në kuadër të listave zgjedhore të subjekteve politike.

Ky propozim, sipas drejtorit të kësaj zyreje, Yll Buleshkaj, ka ardhur si rezultat i paqartësive në pikën "q" të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhje, pikë kjo që ua ndalon kandidimin personave të dënuar në tri vitet e fundit.

Buleshkaj ka theksuar se Zyra që ai drejton ka propozuar që të certifikohen të gjithë kandidatët, duke lejuar hapësirë për ankesa më vonë.

Por, kjo u kundërshtua nga shumica e anëtarëve të KQZ-së të cilët vendosën që të votojnë një nga një për subjektet politike, pasi disa prej tyre nuk i kishin zëvëndësuar kandidatët për të cilët Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) kishte thënë se nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

KGJK-ja kishte thënë se "janë 47 kandidatë nga rreth 1.080, të cilët janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vjetët e fundit".

Sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike për KQZ-në, Lëvizja Vetëvendosje nuk kishte zëvëndësuar 5 kandidatë, ndërsa Nisma Socialdemokrate 12 kandidatë.

Listat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Partisë Demokratike dhe Listës Sërpska janë certifikuar nga ana e KQZ-së.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, tha se subjektet politike dhe kandidatët që vlerësojnë se pa të drejtë nuk janë certifikuar, kanë të drejtë ankese në afat prej 24 orësh në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Çështja mund të shkojë deri në Gjykatën Supreme nëse pala mund të jetë e pakënaqur me vendimin e PZAP-së. Periudha e ankesave është paraparë të përmbyllet deri më 31 janar, në mënyrë që më 2 shkurt të bëhet e mundur tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletëvotimin e këtyre zgjedhjeve.

Anëtari i KQZ-së nga Lëvizja Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ai i AAK-së, Ibrahim Selmanaj si dhe anëtari i Nismës Socialdemokrate, Eshref Vishi thanë se do të shfrytëzojnë të



drejtën e ankesës në PZAP, por edhe në Gjykatën Supreme.
Rekomandimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është bazuar në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, në dhjetor të vitit 2020, ku është thënë se sipas Ligjit për zgjedhje, asnjë person që ka dënim të plotfuqishëm në tre vjetët e fundit, nuk mund të kandidojë për zgjedhje të përgjithshme.
Mediat në Kosovë kanë raportuar se lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti është nga 47 kandidatët që nuk do të mund të garojë si deputetë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.
Më 3 janar, 2018, deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi janë dënuar me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës.
Gjatë mbledhjes së KQZ-së, përfaqësuesi i LV-së, Sami Kurteshi tha se "përpjekja për të ndaluar parti dhe kandidatë të caktuar të dalin në garën e 14 shkurtit po duket qartë, dhe kjo ka të bëjë me emrin e Albin Kurtit".
Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka tha se akuzat e partive politike ndaj saj dhe ndaj institucionit që udhëheqë, kanë për qëllim që të "pamundësojnë zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi".
Në një konferencë për media të enjten, Daka tha se kërcënimet publike ndaj saj dhe "shqetësimet që po i përjeton familja ime janë të paprecedente dhe të rrezikshme".
Ajo nuk tregoi në mënyrë specifike se nga cila parti ka pranuar kërcënime dhe nuk pranoi pyetje lidhur me atë se kush po e kërcënon.
Këto deklarata të Dakës vijnë vetëm një ditë pasi KQZ-ja njoftoi se ka marrë përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ku thuhej se 47 kandidatë për deputetë në zgjedhjet e 14 shkurtit, nuk janë përputhje me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

## Ahmetaj për votimin jashtë vendit: 134 mijë 'email'-a të pahapura do t'i procedojmë gjatë ditëve në vazhdim

Burim Ahmetaj, kryeshef i sekretariatit të KQZ-së, ka treguar se 134 mijë email-a që kanë aplikuar për të votuar në zgjedhjet e 14 shkurtit janë ende të pahapura dhe ato do të procedohen gjatë ditëve në vazhdim. Ahmetaj në mbledhjen e KQZ-së ka thënë se 15 672 aplikues, prej tyre 13 72 aplikues kanë hapur telefonin dhe KQZ-ja ka pranuar konfirmimin e tyre. "14 aplikues kanë deklaruar se nuk janë personat që i kemi të dhënat që kanë aplikuar 2460 aplikues nuk janë realizuar thirrjet telefonike, pra këtij procesi do t'i kthehemi sërish për t'i thirrur. Do t'i kthehemi përsëri procesit për t'i telefonuar të cilët nuk kemi mundur të kemi kontakt, ndërsa 134 mijë email-a janë ende të pahapura", ka thënë Ahmetaj.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ditë më parë ka bërë me dije se 47 kandidatë për deputetë janë identifikuar se janë shpallur fajtorë për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tre vjetët e fundit.

# Brenda 24 orëve, 14 të vdekur nga Covidi në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 22 janar** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 468 mostra të marra (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave rezultojnë 289 raste pozitive më Covid.
Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.
Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë pesë raste (78, 74, 65, 62, 56 vjeç), një rast (47 vjeç), Prizren një rast (88 vjeç), Shtime një rast (80 vjeç), Suharekë një rast (80 vjeç), Viti një rast (71 vjeç), Vushtrri një rast (54 vjeç).
Numri total i rasteve pozitive është 57 317 raste nga 216 409 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 447 raste të vdekjes.
Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 303 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 50 487 raste, kurse numri i rasteve aktive është 5 383. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 107 raste, Gjakovë 22 raste, Podujevë 22 raste, Lipjan 19 raste, Gjilan 14 raste, Fushë-Kosovë 13 raste, Ferizaj 12 raste, Pejë 10 raste, Prizren 10 raste, Drenas 9 raste, Kamenicë 8 raste, Rahovec 8 raste, Viti 8 raste, Obiliq 5 raste, Klinë 4 raste, Suharekë 4 raste, Malishevë 3 raste, Vushtrri 3 raste, Istog 2 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Dragash, Graçanicë dhe Kaçanik. "Numri i rasteve pozitive vazhdon të jetë i lartë dhe brengosë si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. IKShPK përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19", ka njoftuar IKShPK.




## Kategorizimi i ri i komunave sipas zonave

Kategorizimi i ri i komunave sipas zonave (numrit të infektuarve në 100 mijë banorë brenda 7 ditëve). Bazuar në numrin e rasteve brenda një jave në 100 000 banorë, ky është kategorizimi i komunave sipas zonave: Në zonën e kuqe janë 7 komuna: Prishtina, Fushë-Kosova, Podujeva, Mitrovica e Veriut, Mitrovica e Jugut, Zveçani dhe Gjilani. Në zonën e verdhë janë 14 komuna: Suhareka, Lipjani, Obiliqi, Malisheva, Juniku, Vushtrria, Klina, Shtimja, Prizreni, Peja, Gjakova, Graçanica, Kamenica, Ferizaji. Në zonën e gjelbër janë 17 komuna: Deçani, Vitia, Rahoveci, Dragashi, Drenasi, Istogu, Skenderaj, Leposaviqi, Kaçaniku, Kllokoti, Zubin Potoku, Mamusha, Novobërda, Hani i Elezit, Parteshi, Ranillugu dhe Shtërpca.

# Pamkos: Punëtorët e kompanive të pastrimit të përfshihen në programin për rimëkëmbje

**Prishtinë, 22 janar (ER)** - Asociacioni "Pamkos" ka vlerësuar se, pavarësisht prej angazhimit të lartë të kompanive regjionale të mbeturinave në këtë kohë pandemie, sërish puna e tyre nuk është duke u vlerësuar dinjitetshëm prej institucioneve dhe, si rrjedhojë, kanë kërkuar përkrahje financiare dhe përfshirje në Programin për Rimëkëmbje për vitin 2021. Sipas "Pamkos"-it, përgjatë gjithë kësaj periudhe të pandemisë dhe, pavarësisht prej rrezikshmërisë së lartë në punë, punëtorët nëpër të gjitha kompanitë e pastrimit kanë shtuar ritmin e punës dhe, përpos grumbullimit të rregullt të mbeturinave, ata janë angazhuar edhe për pastrimin e vazhdueshëm të hapësirave publike me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik nga pandemia, duke i ndihmuar qytetarët dhe institucionet në vend. "Andaj, si Asociacion i Kompanive Regjionale për menaxhimin e mbeturinave 'Pamkos', u bëjmë thirrje institucioneve të Qeverisë së Kosovës që të mos diskriminojnë punëtorët e kompanive të pastrimit dhe ta rishqyrtojnë mundësinë e përfshirjes të punëtorëve të kompanive të grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Programit për Rimëkëmbje për vitin 2021, të cilët gjatë punës së tyre të pandalshme për bartjen dhe grumbullimin e mbeturinave kanë qenë dhe janë të ekspozuar në shkallë të lartë drejtpërsëdrejti ndaj rrezikut të pandemisë (Covid-19) dhe deri më tani kanë qenë të diskriminuar dhe anashkaluar, duke mos iu atribuuar asnjë përfshirje në pakon emergjente, si dhe në ofrimin e ndihmës ndaj Kompanive Regjionale të Mbeturinave (KRM-të) dhe Kompaninë e Menaxhimit të Deponive në Kosovë (KMDK) për mbulimin e shpenzimeve operative të kompanive, me qëllim që të mund ta përballojmë situatën e rëndë të krijuar në to", thuhet në



reagimin e "Pamkos", duke theksuar se punonjësit e kompanive të bartjes dhe grumbullimit të mbeturinave, si një prej sektorëve kryesor për ruajtjen e shëndetit publik, kanë nevojë të trajtohen me dinjitet, pagë dhe kushte më të mira të punës.

# Hedhet poshtë kallëzimi penal ndaj drejtorit të Urbanizmit në Prizren

**Prizren, 22 janar (ER)** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Beni Kizolli, të premten kanë mbajtur konferencë për media, për ta njoftuar opinionin publik se kallëzimi penal i ngritur drejtorit të DUPH-së, Beni Kizolli, para disa muajsh, është hedhur poshtë nga prokuroria. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se rastet që po paraqiten si kallëzime penale ndaj drejtorëve të Komunës së Prizrenit, kur po hedhen poshtë nga ana e prokurorisë zakonisht nuk po ka njoftime në media. "Ashtu siç po ndodhë edhe në lidhje me kallëzimin penal të ngritur para disa



muajsh ndaj drejtorit të DUPH-së, Beni Kizolli, i cili po ashtu është hedhur poshtë nga ana e prokurorisë", ka thënë Haskuka.
Kryetari Haskuka ka theksuar se Komuna e Prizrenit do të ngrehë kundërpadi për humbjen e kohës, dezinformim të qytetarëve, shpifje dhe dëmtim të imazhit, ngaqë nuk kanë për qëllim sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e qytetarëve, por njollosjen qeverisëse të tij.
Nga ana tjetër, duke folur për kallëzimin penal tashmë të hedhur poshtë, drejtori Kizolli ka thënë se përderisa një pjesë e objektit që gjendet në Qendrën Historike të Prizrenit kishte leje ndërtimore, një pjesë e tij ishte e ndërtuar gjatë vitit 2020 dhe se pronarët e objektit e kishin akuzuar për keqpërdorim të detyrës vetëm për shkak se kërkesa e tyre nuk është trajtuar me ligjin e legalizimit ku, sipas tij, në fushëveprimin e ligjit tregohet shumë qartë se asnjë ndërhyrje pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nuk trajtohet fare.

## Arrestohen dy të dyshuar për disa raste të vjedhjeve

**Mitrovicë, 22 janar (ER)** - Pas një hetimi të vazhdueshëm, hetuesit policorë, në kuadër të Stacionit Policor Jugu në Mitrovicë, kanë arritur t'i identifikojnë dhe t'i arrestojnë dy persona të dyshuar për tri raste të veprës penale "vjedhje". Arrestimi i dy personave të dyshuar është bërë mbi dyshime të arsyeshme dhe prova të siguruara se në bashkëveprim në tri lokacione të ndryshme kanë kryer vepra penale të vjedhjeve, të cilat ishin raportuar ditë më parë, në të cilat caqe të vjedhjeve ishin dyqanet dhe qendrat tregtare, në të cilat ishin vjedhur: pije alkoolike, rroba të ndryshme dhe shtëpiza kompjuteri me pajisje përcjellëse. Si rezultat i identifikimit dhe arrestimit të të dyshuarve, hetuesit policorë kanë lokalizuar vendet ku ishin fshehur gjësendet e vjedhura të cilat janë gjetur dhe janë marrë si prova materiale për t'u proceduar më tutje lidhur me rastet. Ndërsa pas procedurave të nevojshme intervistuese, nga ana e prokurorit të rastit të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt.



# Të punësuarit në arsimin parauniversitar do ta marrin edhe pagën e 13



**Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, pas një takimi me përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), ka bërë me dije se janë pajtuar për të gjitha çështjet në kuadër të Kontratës Kolektive. Ai ka thënë se me përfaqësuesit e SBAShK-ut janë pajtuar që të punësuarve në arsimin parauniversitar t'u paguhet paga e 13-të duke filluar nga viti 2023, bazuar në performancën e tyre**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 JANAR - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, pas një takimi me përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), kryesuar nga Rrahman Jasharaj, ka bërë me dije se janë marrë vesh për të gjitha çështjet në kuadër të Kontratës Kolektive për arsim, duke i saktësuar të gjitha aspektet kryesore të asaj kontrate lidhur me themelimin e marrëdhënies së punës, avancimin, kriteret e punësimit, mënyrën e funksionimit, të drejtat e mësimdhënësve, saktësimin për kohën e punës dhe çështje të tjera me rëndësi që dalin nga Ligji i Punës. "Falënderoj SBAShK-un për gatishmërinë që të bisedojë dhe ta këtë mirëkuptimin e nevojshëm për të arritur marrëveshje në disa aspekte që janë të ndjeshme të Kontratës Kolektive dhe që kanë implikime financiare për buxhetin e vendit", ka thënë kryeministri Hoti.

Ai ka thënë se me përfaqësuesit e SBAShK-ut janë pajtuar që të punësuarve në arsimin parauniversitar t'u paguhet paga e 13 duke filluar nga viti 2023, bazuar në paraqitjen e tyre. "Kemi saktësuar, po ashtu, pagesën e shujtës ditore për mësimdhënësit dhe shpenzimet e transportit", ka thënë kryeministri Hoti. Ai ka theksuar se janë marrë vesh që për shkak të orëve të shtuara të arsimtarëve, si pasojë e pandemisë, zbatimit të modaliteteve të ndryshme të arsimit, arsimtarëve t'u paguhen dy shtesa në pagë, njëra në fund të muajit shkurt, tjetra në fund të majit, në mënyrë lineare për të gjithë, në përputhje me mundësitë buxhetore.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, partia e të cilët është pjesë e qeverisë, ka thënë se është lajm shumë i mirë përmbyllja me sukses e negociatave në mes të SBAShK-ut dhe Ministrisë së Arsimit. "Arritja e marrëveshjes ka një rëndësi të veçantë për procesin arsimor në Kosovë në të gjitha nivelet. Është kohë kur na duhen marrëveshjet dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në të gjitha sferat, në mënyrë që ta tejkalojmë krizën aktuale që na ka prekur të gjithëve. Së shpejti do të zgjidhet edhe çështja e mjekëve dhe personelit mjekësor ashtu siç ishte e paraparë me Ligjin e Pagave. Përgëzoj ministrin e Arsimit, Ramë Likaj, për angazhimin e palodhshëm për arritjen e kësaj marrëveshjeje", ka thënë Haradinaj në një shkrim publikuar në rrjete sociale.

# KMDLNj: Akuzat midis subjekteve politike dhe mediave po ndikojnë në tensionimin e situatës

PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) në një reagim ka theksuar se akuzimi midis subjekteve politike dhe mediave po ndikon drejtpërdrejt në tensionimin e situatës. Sipas KMDLNj-së, fushata zgjedhore, ndonëse zyrtarisht ende nuk ka filluar, po zhvillohet me intensitet dhe dinamikë të përshpejtuar në mënyrë që sa më shumë të shfrytëzohet koha e mbetur nga subjektet që garojnë në këto zgjedhje. "Thuaja të gjitha mediat kanë formuar ekipet e analistëve të cilët përballen me kandidatë të të gjitha subjekteve politike me ç'rast edhe situata del jashtë kontrollit apo temave të




përcaktuara e që janë në interes për publikun. Po në të njëjtën kohë në disa media po bëhen publike edhe hulumtimet për rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021, nga analistë apo institucione të ndryshme. Natyrisht se këto rezultate, varësisht nga subjekti politik, po pranohen apo po kundërshtohen deri në masë që ka thirrje për ndërprerje të bashkëpunimit me disa media. Rasti i fundit ishte ai i TV Dukagjinit ndaj të cilit dy subjekte politike, PDK-ja dhe LDK-ja, po shfaqin dyshime se është në shërbim të një subjekti tjetër duke publikuar rezultate të sondazheve dhe të cilat i konsiderojnë shumë të fryra, joobjektive dhe qëllimkëqija", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj-ja ka bërë me dije se që në fillim të fushatës, e cila po zhvillohet jozyrtarisht, ka kërkuar që politikanët, analistët dhe mediat t'i shmangen fjalorit të dhunshëm, fyes, degradues dhe, i cili, në një mënyrë apo tjetër, do të kontribuojë në tensionimin negativ të situatës. "Për KMDLNj është me rëndësi që mediat të mbajnë raport jodiskriminues me subjektet politike në rrafshin e ofrimit të hapësirës mediale, në përputhje me forcën përfaqësuese politike e që, së paku deri më tani, është respektuar. Mediat nuk kanë asnjë përgjegjësi për rezultatet që i bëjnë publike disa analistë, gazetarë apo institucione që bëjnë hulumtime, por se kjo është përgjegjësi ekskluzive e atyre që publikojnë këto, aq më parë që nëse ua huqin rezultateve përtej marzhës së lejuar të gabimeve, rrezikojnë seriozisht besueshmërinë dhe integritetin profesional si të individit ashtu edhe të institucionit që e përfaqësojnë. Askush nuk ia ndalon një x politikani, x analisti apo x institucioni t'i publikojë sondazhet ku ndonjë subjekt politik e nxjerr fitues me 90 apo 100 për qind të votave. Këto janë sondazhe për një përdorim me shkallë 90 apo 100 për qind të mosbesimit!", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë kontekst, KMDLNj thërret subjektet politike të kenë kujdes me mediat, ta ndërtojnë frymën e bashkëpunimit reciprok në mënyrë që publikut t'i ofrojnë kohë dhe mundësi të përcjellin debate konstruktive, t'i bëjnë publike programet politike dhe ekonomike, gjithnjë në përputhje me rrethanat dhe mundësitë e krijuara apo, më mirë të thuhet, të kufizuara për shkak të pandemisë.

# Humbjet e bizneseve, të pallogaritshme



Sipas të dhënave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në territorin e Kosovës janë të regjistruara rreth 20 mijë biznese në sektorin e gastronomisë.
Për t'u dalë në ndihmë, Qeveria në detyrë e Kosovës ka ndarë tre milionë euro për ta subvencionuar sektorin e gastronomisë. Në këtë sektor hyjnë restorantet, sallat e dasmave, sallat e sportit, qendrat rehabilituese, si dhe aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit

PRISHTINË, 22 JANAR - Për "Hotel Magra Austria" në Bogë të Komunës së Pejës dhe "Hotel Magra Austria 2" në Bërnicë të Epërme të Komunës së Prishtinës, humbjet janë të pallogaritshme gjatë vitit të kaluar për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, thotë pronari i këtyre hoteleve, Skënder Thaçi.

Ai tregon se në hotelin në Bogë vitin e kaluar nuk ka pasur klientë të mjaftueshëm, kurse në "Hotelin Magra Austria 2" në Prishtinë, përjashtuar vitin e kaluar, për çdo vit ka pasur organizime të dasmave apo tubime të ndryshme familjare.

Nga mosorganizimi i ndejave dhe ndalimi i grumbullimit të qytetarëve si pjesë e masave kufizuese të qeverisë në detyrë, fitime në qarkullim nuk ka pasur, thotë Thaçi. Për shkak të masave mbrojtëse kundër koronavirusit, me vendim të qeverisë nga muaji mars i vitit të kaluar, ka qenë i ndaluar organizimi i dasmave. "Problemet financiare kanë filluar në muajin qershor, pas lehtësimit të masave për lëvizje, sepse u rritën shpenzimet dhe ato ishin kolosale, pasi puna nisi nga fillimi. Çdo ditë duhet të përgatitesh, të mbash një numër të të punësuarve, kurse për shkak të masave kanë munguar klientët. Ne nuk mund të llogaritim fitimin e humbur, sepse është e pallogaritshme", thotë Thaçi.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në territorin e Kosovës janë të regjistruara rreth 20 mijë biznese në sektorin e gastronomisë.

Për t'u dalë në ndihmë, Qeveria në detyrë e Kosovës ka ndarë tre milionë euro për ta subvencionuar sektorin e gastronomisë. Në këtë sektor hyjnë restorantet, sallat e dasmave, sallat e sportit, qendrat rehabilituese, si dhe aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit. Duke përjashtuar restorantet që kanë punuar me orar të kufizuar, varësisht nga lejimi i masave, aktivitetet e tjera e kanë pasur të ndaluar zhvillimin e veprimtarive të tyre për shkak të masave kufizuese të Qeverisë së Kosovës.

## Thaçi: Tre milionë euro, të pamjaftueshme

Shuma prej tre milionë eurosh po duket qesharake dhe e pamjaftueshme për Skënder Thaçin, i cili është edhe nënkryetar i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit në Kosovë. Disa biznese që nuk kanë punuar nga muaji mars, thekson ai, janë afër falimentimit dhe kjo vlerë nuk mjafton për rimëkëmbjen e tyre. Thaçi thotë se qeveria në detyrë në fokus është dashur t'i ketë bizneset, në mënyrë që më pas këto të krijojnë vende të reja pune, rrjedhimisht të përmirësohet gjendja sociale. "Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike qeveria në detyrë e ka shndërruar në pako sociale, sepse vlera prej tre milionë eurosh është e papërfillshme dhe unë nuk e di se si do t'i mbulojnë humbjet dhe shpenzimet e sektorit të hotelerisë, gastronomisë dhe të tjerëve, se ky sektor është i lidhur zinxhir me biznese të tjera", shprehet ai.

## Rukiqi: Ligji është për Rimëkëmbje Ekonomike, jo sociale

Edhe Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës është i pakënaqur në përgjithësi me shumën e ndarë për bizneset nga plani për rimëkëmbje ekonomike. Në bazë të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, ai thotë se ishte paraparë që të ndahen më shumë se 200 milionë euro për sektorin privat që ka pësuar humbje nga pandemia. "Është mirë që është ndarë një buxhet i veçantë për gastronominë, megjithatë, duke pasur parasysh humbjet e mëdha që kanë pasur sidomos bizneset që nuk kanë punuar fare, siç janë hotelet, sallat e dasmave, nuk e di sa do të jetë i mjaftueshëm", thekson Rukiqi. Qeveria në detyrë e Kosovës, në bazë të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, më 15 janar ka ndarë për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë tre milionë euro për ta subvencionuar sektorin e gastronomisë.

## Krasniqi: MTI-ja pret alokimin e mjeteve për shpërndarje

Pavarësisht prej shumës, ministri në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se pret alokimin e mjeteve nga Ministria e Financave në mënyrë që të fillojë procedura e aplikimit, rrjedhimisht shpërndarja e mjeteve. Krasniqi tregon se subvencionimi i këtyre bizneseve do të realizohet në bazë të humbjeve që kanë pasur gjatë periudhës së pandemisë, ndërkaq prioritet do t'i kenë bizneset që nuk kanë punuar fare. "Ne jemi duke i përgatitur kriteret në bazë të udhëzimeve që kemi në fuqi. Ajo që do të kërkohet nga biznesi, është që t'i paraqesë humbjet financiare dhe sa ka qenë periudha e mbylljes, sepse veprimtaria dallon nga veprimtaria", thekson Krasniqi.

## Bajrami: Shpërndarja e mjeteve varet nga inkasimi i mjeteve në buxhet

Por, ministrja në detyrë e Financave, Hykmete Bajrami, ditë më parë ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shpërndarja e mjeteve do të realizohet në bazë të grumbullimit të mjeteve në buxhetin e Kosovës. "Ky është program njëvjeçar, sepse buxheti është projeksion. Në muajin janar ne nuk e kemi në dispozicion buxhetin e aprovuar 2.4 miliardë euro. Normalisht, sipas projeksioneve tona 1/12 vjen në muajin janar, mandej 1/12 në muajin shkurt e kështu me radhë. Ndonjë muaj mund të kemi të hyra më të mëdha. Pra, do të thotë, me dinamikën e inkasimit të mjeteve, të njëjtën dinamikë do ta përcjellë edhe shpenzimi i këtyre mjeteve", thekson Bajrami.

Ndryshe, 222 milionë euro është vlera e mjeteve në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky ligj është miratuar më 4 dhjetor 2020 në Kuvendin e Kosovës, porse ekzekutimi i mjeteve ka qenë i pamundur deri në miratimin e buxhetit të Kosovës, i cili është votuar më 29 dhjetor të vitit të kaluar. Kurse më 15 janar kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti ka prezantuar 16 masa për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike për vitin 2021. Në këto masa përfshihet ndihma për sektorin privat, atë shëndetësor dhe skema sociale.

# ‘Askush, për interesa private dhe grupore, nuk do të mund t’i falimentojë Telekomin dhe Postën’

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 JANAR - Me iniciativën e ushtruesit të detyrës të kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Zeqir Kiqina dhe të ushtruesit të detyrës së kryeshefit të Postës së Kosovës, Xhevdet Smakiqi, është mbajtur një takim me dy kryetarët e Sindikatave të Punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve, Lamih Balaj dhe Bujar Shala.

Sipas një njoftimi të Postës së Kosovës, pas një diskutimi me transparencë të plotë nga ana e menaxhmentit dhe sindikatave, është shqyrtuar në hollësi gjendja e rëndë afariste dhe financiare e të dy ndërmarrjeve publike, Postës së Kosovës dhe Telekomit, strategjitë dhe planet për tejkalimin e kësaj gjendje që dikur i kanë dhënë dividentë aksionares, Qeverisë së Kosovës, mbi apo rreth 500 milionë euro. “Menaxhmenti dhe sindikatat u pajtuan plotësisht se muaji shkurt 2021 është shumë sfidues dhe kërkon aktivitete të reja, të vendosura dhe të koordinuara për t’i mbrojtur e mbajtur aktive dhe operative të dyja ndërmarrjet tona publike, nga të cilat varet mirëqenia e mbi 4 000 familjeve të Kosovës”, është thënë në njoftimin e Postës së Kosovës.



Sindikata e Postës dhe ajo e Telekomit kanë paraqitur strategjinë e tyre dhe vendosmërinë se zgjidhja e vetme është te shkaktari, pra te Qeveria e Kosovës si aksionare, që nuk po i përmbush obligimet e saj si pronare e të dy ndërmarrjeve publike, Postës së Kosovës dhe Telekomit të Kosovës. “1. Ekzekutimi i pagave për të dyja ndërmarrjet publike do të bëhet i sinkronizuar që, nëse ekzekutohen pagat e Telekomit për secilën kategori në cilëndo datë të muajit, menjëherë ditën e nesërme (në varësi të ekzistimit të kesh-it, por jo më larg se tjetrën ditë të punës), do të ekzekutohen për punëtorët e Postës së Kosovës; 2. Të shtohet disiplina në punë dhe përgjegjësia në punë e të gjithë punonjësve të Postës së Kosovës dhe Telekomit të Kosovës dhe se opsioni për të protestuar në vendin e punës nuk është strategjia e duhur; 3. Nuk do të lejohet më tutje injorimi i gjendjes së rëndë dhe mospërmbushja e obligimeve të Qeverisë ndaj Postës së Kosovës dhe Telekomit të Kosovës; 4. Nuk do të lejohen cenimi dhe pasiguria, si dhe mirëqenia e rreth 4 000 punonjësve të të dy ndërmarrjeve tona publike, asete jetike të shtetit të Kosovës; 5. Nuk do të lejohet bllokimi i mëtutjeshëm i llogarive bankare, as nga qeveria dhe as nga operatorët privatë, si dhe as nga ‘Z-mobile’; 6. Nuk do të lejohet më tutje që qeveria të heshtë përballë obligimeve që i ka ndaj dy ndërmarrjeve nga dëmi që iu është shkaktuar nga pandemia Covid-19; 7. Do të kërkohet me mirëkuptim dalje nga situata, ku politika i ka futur këto dy gjigante të Kosovës; 8. Sindikatat do t’i shtojnë veprimet e tyre, deri në grevë urie pranë Zyrës së Kryeministrit Avdullah Hoti dhe ministrit të MEA-së”, është theksuar në njoftimin e Postës së Kosovës, duke shtuar se “askush, për interesa private dhe grupore, nuk do të mund t’i falimentojë Telekomin dhe Postën e Kosovës”, është thënë në këtë njoftim për media.

# Faturat e energjisë elektrike deri në maj do t’ju vijnë më lirë




PRISHTINË, 22 JANAR (ER) - Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike parasheh edhe subvencionimin e konsumatorëve të energjisë elektrike. Pjesa e energjisë elektrike që ata paguajnë për energjinë elektrike që e marrin nga prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtëritshme do të subvencionohet, pasi qeveria, në bazë të ligjit, ka ndarë një shumë deri në 16 milionë euro e cila do t’u jepet atyre prodhuesve përmes KOSTT-it. “Pra, mjetet do të derdhen në këtë kompani e nga aty te prodhuesit. Kjo do të zgjasë nga janari deri në maj. Kjo nënkupton që shuma që e përfitojnë këta prodhues do t’u zbritet konsumatorëve. Në bazë të kalkulimeve del që konsumatorëve do t’u zbritet në faturat e tyre çmimi prej 0.0061 centësh për kilovat/orë të shpenzuar nga tash deri në maj. Kjo nënkupton që nëse një konsumator ka shpenzuar 1000 kilovatë/orë gjatë një muaji, fatura do t’i vijë 6.1 euro më lirë. Pra, subvencionimi është i lidhur direkt me prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme (BRE), rrjedhimisht zbritja në euro lidhet me konsumin e energjisë elektrike”, ka njoftuar KEDS-i.

Ekspertët e KESCO-s kanë bërë maksimumin që përgatitjet për implementimin e kësaj zbritje të bëhen me kohë dhe kësaj ia kanë arritur me sukses të plotë. “Tashmë çdo gjë është gati dhe kjo zbritje ka filluar të implementohet në fatura. Çmimet e energjisë elektrike caktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Këto çmime në Kosovë, sipas agjencisë zyrtare të statistikave të Bashkimit Evropian, ‘Eurostat’, janë më të lirat në Evropë”, ka njoftuar KEDS-i.

# Shënohet përvjetori i sulmit të dytë ndaj familjes Jashari

SKENDERAJ, 22 JANAR (ER) - Për nder të përvjetorit të 23-t të triumfit të familjes Jashari mbi sulmin e dytë të forcave serbe, i pari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, bashkë me motrën, Besartën dhe djalin, Hamzën, nënkryetarin e komunës, Nuredin Lushtaku, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, ish-deputetin Bekim Haxhiu, drejtorë komunalë, asamblistë, zyrtarë komunalë dhe qytetarë, në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz bënë homazhe në shenjë nderimi për luftën heroike të familjes Jashari.

Kryetari Jashari me rastin e këtij përvjetori ka thënë se disfata që pësoi 23 vjet më parë regjimi shovinist serb nga familja Jashari ishte sinjal i qartë që liria po vjen. "Jemi përherë krenarë dhe mirënjohës për sakrificën e dëshmorëve të kombit. Lavdi të rënëve që jetësuan ëndrrën tonë shekullore për liri dhe pavarësi", ka thënë Jashari.



# Ekipet e shëndetësisë në Gjilan realizuan 33 vizita shtëpiake te pacientët e infektuar nga Covidi



GJILAN, 22 JANAR (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, i cili është udhëhequr nga nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin e radhës për vlerësimin e përballjes me virusin në dy ditët e fundit. Në këtë takim u bë me dije se ekipet e shëndetësisë primare kanë realizuar të enjten 33 vizita në shtëpi të pacientëve të prekur me Covid-19.

Nënkryetari Arbër Ismajli u ka bërë thirrje qytetarëve, gastronomisë dhe qendrave tregtare, që të vazhdojnë t'u përmbahen rekomandimeve të profesionistëve për bartjen e maskave, për mbajtjen e distancës dhe për pastrimin e duarve, si e vetmja mënyrë kundër përhapjes së virusit.

Gjendja e përgjithshme e Gjilanit sa i përket përballjes me pandeminë brenda dhjetë muajve është si vijon: Nga 8 906 mostra, 3 333 persona kanë rezultuar pozitivë, 3 054 të shëruar, 104 të vdekur, 175 raste aktive, 28 të konfirmuar me virusin janë të shtrirë në spitale dhe 70 persona po presin rezultatet e testimit.

# Komuna e Malishevës dhe Bashkësia Islame, marrëveshje për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

Malishevë, 22 janar (ER) - Komuna e Malishevës, e përfaqësuar nga nënkryetari i komunës, Hajdin Berisha dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë, i përfaqësuar nga kryetari i këshillit, hoxhë Sead Paçarizi, e kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Malishevës për vitin 2021.

Paraprakisht, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka marrë vendim për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve për vitin 2021.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeve ka thënë se "jemi ndër komunat e para në vend që kemi filluar dhe po vazhdojmë mbulimin e shpenzimeve për rastet e varrimit", ndërsa kreu i KBI në Malishevë, hoxhë Sead Paçarizi, gjithashtu është shprehur "i kënaqur me këtë veprim të Komunës së Malishevës, pasi është diçka humane dhe krijon lehtësim për familjarët".



# Bulliqi vizitoi Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë

PODUJEVË, 22 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar të premten Qendrën e Shëndetit Mendor në Podujevë, ku është takuar me drejtorin regjional të Qendrës së Shëndetit Mendor në Prishtinë, Sami Rexhepi, me të cilin ka biseduar për format e bashkëpunimit me qëllim të rritjes së mbështetjes për këtë qendër.

Gjatë vizitës në Qendrën e Shëndetit Mendor, kryetari Bulliqi dhe drejtori Rexhepi kanë biseduar për gjetjen e mundësive për trajtim institucional të personave me sëmundje mendore, veçmas për rastet të cilat nuk kanë përkujdesje familjare.

Bulliqi ka shprehur gatishmërinë e plotë të Komunës së Podujevës për t'i ofruar ndihmën e nevojshme Qendrës së Shëndetit Mendor në Podujevë (QSHM), për të qenë sa më efikase për kryerjen e vizitave dhe intervenimeve në terren. Për këtë qëllim kryetari Bulliqi u zotua se kësaj qendre do t'ia japë në shfrytëzim një automjet për intervenime në terren, që është në pronësi të komunës.

Gjatë vizitës në këtë qendër, në të cilën ishin të pranishëm edhe drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Egzona Mustafa dhe shefi i kabinetit të kryetarit, Bajram Ajeti, kryetari Bulliqi mori zotimin e drejtorit Rexhepi se do të angazhohet për transferimin e personave me gjendje më të rëndë në qendrat përkatëse për trajtim adekuat.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (8)

# Afrim Mehmeti tregon për natën kritike të 2 shtatorit të vitit 1987



Lulzim SAHITI

*Pas një ore i njëjti komandant, Alibashiq, erdhi me vonesë dhe më informoi për vrasjet në kazermë të cilën e kishte bërë Aziz Kelmendi. Edhe pse më kishte kaluar afati i rojës aty, të përforcuar edhe me një ushtar, më lanë deri në mëngjes. Kah ora 6:00 e mëngjesit, kur shkova në kazermë, sërish më caktuan që të bëja roje në dhomat ku paraprakisht ishin vrarë ushtarët. Aty pashë kufomat, pashë gjakun, pashë krevatet të cilët ishin të shpartalluar, pashë krevatin tim mbi të cilin ishte gjuajtur mirëpo, për fat, unë nuk kam qenë aty. Menjëherë pas kryerjes së rojës filluan të më marrin në pyetje. Edhe kryenim detyrat ushtarake edhe na merrnin në pyetje. Pyetjet ishin sistematike dhe në pyetje i merrnin të gjithë ushtarët. Në pyetje fillimisht nuk "dyshonin në lidhshmërinë tonë", por pyesnin gjithçka: Çfarë kemi parë, çfarë kemi dëgjuar…*

Afrim Mehmeti nga Firaja e Shtërpcës më 13 maj të vitit 1997 ka përfunduar vuajtjen e dënimit dhe është liruar nga Burgu i Nishit. Ai përndryshe ishte në një dhomë me Aziz Kelmendin dhe për natën kritike tregon: *"Në mbrëmjen e 2 shtatorit të vitit 1987, rreth orës 21:30, në korridorin e pavijonit apo katit të parë të pavijonit, në tavolinën ku bëhej kujdestaria, unë bashkë me Aziz Kelmendin, Enver Behlulin... qëndruam për një periudhë të shkurtër, deri sa bëheshim gati për të fjetur. Këto ndeja të rastit bëheshin shpesh nga ushtarët shqiptarë duke diskutuar shpesh, temat aktuale të asaj kohe. Ajo që më kujtohet është se së bashku me Azizin kemi hy në të njëjtën dhomë për të bërë gjumin dhe mbajë në mend se dikush Azizit i ka thënë se sonte je në shërbim të kujdestarisë dhe Azizi ka bërë një reagim për këtë caktim të tij në këtë shërbim, por jo ndonjë reagim kategorik, vetëm duke i thënë pse më keni caktuar në shërbim të kujdestarisë. Sipas praktikave, caktimi në detyrë bëhej për çdo ditë në rreshtimin e mëngjesit, por ka pas raste të ndryshimeve edhe në rastet e më hershme për shkak të problemeve shëndetësore që u ndodhnin ushtarëve gjatë ngarkim-shkarkimit të municionit. Ka qenë një punë shumë e rëndë, të gjitha llojet e peshave të municionit bëheshin me krah, nuk ka pas mekanizëm.*

*Pas mesnatës, më 3 shtator 1987, rreth orës tre të mëngjesit isha në shtratin e gjumit dhe për një çast ma nxorën gjumin disa krisma nga thyerjet e xhamave të dritareve. Njëkohësisht kisha dëgjuar edhe krismat e pushkës. Gjithçka më dukej sikur jam në ëndërr. Për një moment apo instinktivisht kam marrë një pozicion të shtrirjes nën shtrat për t'u mbrojtur. Këtë veprim e kam bërë, se kisha një ndjenjë se po sulmohemi nga ana e dritareve. Ka qenë pothuajse një minutë kohë kur unë kam dëgjuar zhurmën e ushtarëve në pavijon dhe kam dalë në korridor. Porsa hapa derën, në krye të shkallëve, të cilat ishin shumë afër dhomës së gjumit ku kishim fjetur unë dhe Azizi, kam parë disa ushtarë duke lëvizur vërdallë. Pothuajse të gjithë ishin të çorientuar. Menjëherë më ra në sy një ushtar mysliman-boshnjak, Nexhid Mehmedoviq, i plagosur rëndë në njërën këmbë. Ishte ulur duke ulëritur për dhimbjet që kishte. M'u drejtua me disa fjalë, po as sot nuk kam mbajtur në mend çfarë më tha. Për një moment e kuptova se kishte diçka kundër meje dhe u bëra sikur nuk e kuptova. Në ato çaste një ushtar maqedonas, Zvonko Zatkovski, me të cilin deri në ato çaste kishim raporte të mira, m'u drejtua: "Ai vendasi (zemljaku) yt Azizi ka vrarë shumë ushtarë dhe ka ikur. Dhe po ta nxëmë kemi me gozhduar në mur!" Unë vetëm dëgjoja dhe për të gjithë shqiptarët ishte një moment i trishtueshëm nga frika e ndonjë hakmarrje. Secili na shikonte me një gjuhë tjetër të urrejtjes. Mbaj në mend se kur takoja secilin ushtar shqiptar, i thoshim njëri-tjetrit se tani e tutje mund ta kemi vështirë dhe mendonim veç për mbrojtje. Në ato çaste e gjithë kazerma ishte në alarm apo, më mirë të thuhet, në një situatë të veprimeve të çrregullta. Alarmi ishte se Azizi është i armatosur dhe mund të ketë sulme të tjera.*

*Të jemi realë, të gjithë ne shqiptarët që komunikonim në mes vete i thoshim njëri-tjetrit, shpresojmë që Azizin të mos e zënë të gjallë. Kjo përshtypje ishte për shkak se në sytë e secilit ushtar joshqiptar u kuptua, se jo vetëm Azizi, por të gjithë ne mund të pësonim në të njëjtën mënyrë të vrasjes apo ekzekutimit. Të kuptohemi, në kazermë mbretëronte një situatë e rëndë dhe e nderë.*

*Për një kohë të shkurtër në kazermë kanë arritur shumë eprorë ushtarakë. Nga të parët që më ka takuar ka qenë një oficer (nuk mbaj në mend emrin) se nuk ishte oficer i njësisë time dhe e kam kuptuar se, përveç shërbimit të zakonshëm, kishte qenë edhe në shërbim informativ ushtarak.*

*Këtë e kuptova pasi ai filloi të më marrë menjëherë në pyetje. Pyetjet ishin kryesisht të natyrës së*



Afrim Mehmeti



Pajazit Aliu

*shoqërimit tim me Azizin. Pastaj më urdhëroi të futem në dhomën e gjumit, ku m'i dha disa letra të shkruara të Azizit. Letra që Azizi kishte pasur nga shoqëria dhe familja. Pasi përktheva dy apo tri letra në gjuhën serbe, pas një ore më tha të ndërprisja. Për një moment erdhi lajmi se Azizi ishte vrarë apo vetëvrarë, qarkullonin të dy variantet. Këto informata qarkullonin nga ushtarët e pranishëm por, jozyrtarisht. Për një kohë shumë të shkurtër u përhap lajmi se në kazermë gjenden edhe prindërit e Azizit, nëna Salë dhe axha Sadik. Unë nuk besoja për një moment, por që kishte qenë e vërtetë, sepse i pashë edhe vetë. Se si ka shkuar puna me prindërit e Azizit nuk kam qenë më në ngjarje. Sepse shumë nga oficerët më merrnin në pyetje dhe nuk e kam parë më ngjarjen se si zhvillohej. Por për një moment kur isha duke u marrë në pyetje, hyri brenda zyrës një oficer dhe po i thotë na duhet Afrimi që ta identifikojë Azizin. Edhe pse më vonë e kuptova se po të njëjtën gjë e kishin bërë edhe me prindërit e Azizit. Por edhe unë shkova, me mua erdhën edhe tre oficerë që unë nuk i njihja. Nuk ishin oficerë të kazermës që ne kishim shërbyer. E shpalosën të ndjerin. Unë e identifikova menjëherë se ishte vetë Azizi. Më kujtohet se derisa e pashë Azizin, të gjithë këta oficerë ishin duke më shikuar mua. Unë pohova se është Azizi. Njëri nga oficerët më është drejtuar: "Si po e njeh kaq shpejt? Ndërhyri njëri nga ata duke i thanë: 'Se ky është shoku i ngushtë i tij'. U larguam pa bërë zë, në drejtim të të njëjtës zyrë që isha duke u pyetur për rastin.*

Pajazit Aliu nga Pakashtica e Epërme e Podujevës: *Në orën 3 e 05 minuta, në dhomën ku isha duke fjetur në gjumë të thellë, janë dëgjuar krismat e automatikut, të cilat më zgjuan nga gjumi. Porsa hapa sytë, më shkuan kah dera e dhomës. I përgjumur vërejta një figurë të njeriut që gjuante nëpër ushtarë. Atëherë kam dëgjuar britma të ushtarëve të tmerruar. Në ato çaste, të plagosur për vdekje kam parë Safet Dudakoviqin, shtrirë në krevat dhe e kam dëgjuar kur ka thënë:"Bëhet mirë" (Bi e bolje). Po në atë moment kam vërejtur Srgjan Simiqin që ishte i shtrirë ndërmjet shtretërve dhe kokën e kishte të mbështetur për ormani (kasetë). Jam nis prej derës e drejt te Goran Begiqi dhe e pashë se edhe ky ishte i vdekur. Të gjithë ushtarët ishin në këmbë duke bërtitur ndihmë. Në ato çaste jam kthyer drejt shtratit tim dhe i kam thanë Shefqet Paçarizit të m'i japë teshat nga ormani t'i vesh se ai ishte duke u veshur. M'i gjuajti teshat e mia mbi krevat. Jam veshur dhe jam nisur me Shefqetin në drejtim të derës së dhomës. E kam vërejtur të plagosur Ante Jazhiqin që përpiqeshin ta shtrinin në krevat. Në dhomën tonë ishte plagosur edhe Nexhid Mehmedoviq. Unë nga dhoma numër 42 kam dalë në korridor duke mos ditur se çfarë ka ndodhur në dhomën numër 41. Porsa dola në korridor nuk gjeta askënd. Jam kthyer sërish në dhomë dhe u kam thënë të pranishmëve se në korridor nuk ishte askush. Menjëherë ushtarët kanë filluar të dalin nga dhoma. Atëherë u njoftuam se ka të vrarë dhe të plagosur edhe në dhomën tjetër. Kam hyrë në dhomën tjetër dhe kam vërejtur se është i vrarë Hasim Gjananoviq dhe tre të tjerë ishin të plagosur: Huso Kovaçeviq, Andrej Presheren dhe Petar Gjekiq, kurse nga dritarja e dhomës kishte kërcyer Nazif Axhoviq, shqiptar nga Mali i Zi.*

*Ndërkohë i kanë marrë të plagosurit me autoambulancë për t'i dërguar në Spitalin Ushtarak të Nishit. Më vonë na kanë thënë të gjithë ushtarët të bëhen rresht dhe drejt nga pavijoni të shkojnë nëpër klasë. Dolën të gjithë dhe secili hynte në klasat e veta. Në orën 8:00 erdhi lajmi se Aziz Kelmendi ka bërë vetëvrasje. Diku rreth orës 10:00 një helikopter ka aterruar në fushë të sportit në Paraqin. Thuhej se atë ditë nga Beogradi ka ardhur sekretari federativ i Mbrojtjes Popullore, admiral i flotës Branko Mamulla. Rreth orës 12:00 na kanë ftuar të gjithë ushtarëve të shkruajmë nga një deklaratë. Porsa i dorëzuam në zyrë deklaratat, ishte koha e drekës. Pas pak kohe një ushtar më tha, eja se po të thërrasin në raport. Shkova, eprori i sigurimit shtetëror kishte qenë duke më pritur në korridor. Kur hyra me të në zyrë, aty kishin qenë edhe dy eprorë të tjerë, të cilët nuk i njihja. Po më pyesin se çfarë kam shkruar? Fillova të përsëritja me gojë atë çfarë kisha shkruar më parë. Më pas më pyetën: Çfarë ushtari ka qenë Azizi? Ju them: Si çdo ushtar tjetër. Dil jashtë, më thanë. Dola në korridor. Aty kishin qenë Shefqet Paçarizi dhe Afrim Mehmeti, të cilët më thanë të kam kujdes se çfarë po flas. Ndërkaq, pas darke kemi shkuar të gjithë së bashku për t'i dëgjuar lajmet. Shkuam dhe u kthyem, por askush nuk fliste. Atë natë na dërguan të flemë në dy dhoma të tjera. Mua më kishin mbetur edhe dhjetë ditë për ta kryer shërbimin ushtarak. Më 7. 9. 1987 i kanë transferuar të gjithë ushtarët e Paraqinit në kazerma të ndryshme të Jugosllavisë, ku mua më dërguan në Kazermën Ushtarake të Nishit.*

Pikërisht në ditën që duhej të udhëtonte për në shtëpi, Pajazit Aliu më 13 shtator të vitit 1987 ishte paraburgosur nga policia ushtarake dhe dërguar në hetuesinë kriminale të Burgut Ushtarak të Nishit. Më 28 janar 1988 Pajaziti në shkallën e parë të Gjyqit Ushtarak të Nishit është dënuar me 10 vjet heqje lirie, kurse më 20 prill 1988 shkalla e dytë e Gjykatës Supreme Ushtarake në Beograd ia ngriti dënimin në 13 vjet burg. Më 24 maj të vitit 1997 ka përfunduar dënimin dhe është liruar nga Burgu i Nishit.

**Isuf Ponik nga Prizreni:** *Natën kritike kam qenë duke fjetur rreth tri kilometra larg Kazermës Ushtarake të Paraqinit, në vendin e quajtur "Karadjordjevo Brdo". Atje ishim në vendroje të depove të municionit dhe armatimit. Me mua ishin edhe dy shqiptarë: Sejfullah Selimoviq, me detyrë udhëheqës i qenve dhe Feti Zuka që bënte roje si unë. Pas të shtënave brenda Kazermës "Branko Krsmanoviq" që kishin ndodhur, tek ne kanë dhënë menjëherë alarm duke na vënë të gjithëve në gjendje gatishmërie. Na kanë treguar që Aziz Kelmendi ka sulmuar Kazermën dhe është i armatosur. Mua ma kanë dërguar në vendrojën numër 1. Rreth orës 3 e 40 minuta kam dëgjuar një të shtënë, por nuk e kam ditur se kush ka gjuajtur. Më vonë u kuptua se kjo e shtënë ka qenë nga Aziz Kelmendi, për të cilin thuhej se ka bërë vetëvrasje.*

*Pas tri-katër dite të "Rastit Paraqini" më kanë transferuar në një kazermë të vogël ushtarake në Nish, ku ushtarët e saj merreshin kryesisht me çështje mjekësore. Atje gjatë shërbimit tim katërmujor më kanë marrë në pyetje vazhdimisht inspektorët e sigurimit ushtarak. Kanë bërë presion të madh psikik në mënyra të ndryshme duke kërkuar nga unë të pranoj se kam ndihmuar Aziz Kelmendin.* **(Vijon)**




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Sot dy derbi në Superligë

**Në Superligën e basketbollit sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshje derbi. Në Rahovec "Vreshtarët" e presin Prishtinën, kurse Ponte Prizreni e pret skuadrën e Pejës. Të dielën zhvillohen dy ndeshjet e tjera. Takohen Trepça - Ylli dhe Bashkimi - Vëllaznimi**



**SUPERLIGA E MESHKUJVE - JAVA 17**

**E shtunë takohen:**
15:00 Rahoveci - Sigal Prishtina
17:00 Ponte Prizreni - Peja

**Të dielën takohen:**
17:00 Trepça - Golden Eagle Ylli
19:00 Bashkimi - Vëllaznimi

**SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 11**

**Të shtunën takohen:**
13:00 Bashkimi - Penza
14:00 Kastrioti - Vëllaznimi

**Të dielën takohen:**
13:00 Trepça - Prishtina

PRISHTINË, 22 JANAR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 17-të e Superligës së Kosovës në basketboll. Sfida e parë do të zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Sigal Prishtinës. Takimet ndërmjet këtyre dy skuadrave kanë qenë interesante në vitet e fundit dhe kështu pritet të jetë edhe të shtunën. "Vreshtarët" janë në vendin e parë me 12 fitore dhe katër humbje, kurse prishtinasit kanë katër fitore dhe 12 humbje. Ndeshje shumë interesante shihet ajo ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Pejës, dy skuadrat që kanë grumbulluar nga 27 pikë, 11 fitore dhe pesë humbje. Skuadrat janë në formë të mirë dhe kjo pritet ta bëjë edhe më interesante këtë përballje. Trepça, pas dy fitoreve radhazi, do të ndeshet me Golden Eagle Yllin, që në dy xhirot në stinorin pranveror ka mundur Ponte Prizrenin dhe Bashkimin. Fitorja është shumë e vlefshme për të dyja skuadrat të cilat kanë ambicie të ndryshme. Mitrovicasit kanë katër fitore dhe 12 humbje, ndërsa therandasit dhjetë fitore dhe gjashtë humbje. Bashkimi - Vëllaznimi është ndeshja e fundit për këtë xhiro. Të dyja skuadrat janë pa fitore në stinorin pranveror, andaj përballja do të jetë shumë interesante. Prizrenasit kanë tetë fitore dhe tetë humbje, kurse kuqezinjtë katër fitore dhe 12 humbje.

## Rikthehet Superliga e femrave

Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 11-të në Superligën e Femrave, e para në stinorin pranveror. Ky edicion pritet të jetë shumë interesant, pasi të gjitha skuadrat kanë bërë përforcime për t'i realizuar synimet që kanë. Ndeshja më interesante do të jetë ndërmjet Bashkimit dhe Penzës. Skuadra prizrenase ka nëntë fitore dhe një humbje, kurse ajo pejane pesë fitore dhe pesë humbje, por ka bërë disa përforcime, andaj ndeshja pritet të jetë mjaft interesante. Kastrioti do të ndeshet me Vëllaznimin. Skuadra ferizajase ka një fitore dhe nëntë humbje, kurse ajo kuqezi tetë fitore dhe dy humbje. Takimi i fundit është ndërmjet Trepçës dhe Prishtinës. Mitrovicaset kanë një fitore dhe nëntë humbje, ndërsa prishtinaset gjashtë fitore dhe katër humbje.

# MKRS-ja licencon Federatën e Golfit



PRISHTINË, 22 JANAR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka licencuar Federatën e Golfit. Ministrja Vlora Dumoshi, gjatë takimit me kryetarin e kësaj federate, Blerim Sejdiu, ka diskutuar për aktivitetet sportive që organizon kjo federatë. "Licencimi i Federatës së Golfit është bërë me qëllim të një organizimi më të mirë të jetës sportive në vend. Me anë të këtij licencimi besojmë se do të ketë aktivitete dhe gara të strukturuara duke pasur parasysh interesimin që keni shprehur ju Federata e Golfit. Ministria do ta përkrahë këtë federatë në kuadër të politikave që ka për sportin", ka thënë ministrja Dumoshi.

Dumoshi dhe Sejdiu kanë biseduar edhe për hapat konkretë që duhen ndërmarrë në të ardhmen. Ndërkaq, kryetari i Federatës së Golfit e ka informuar ministren lidhur me gjendjen aktuale, për planet e federatës dhe për aktivitetet të cilat do të mbahen gjatë këtij viti.

# Bie çmimi i Rashicës



Bremen, 22 janar - Werder Bremeni po shpreson ende ta shes Milot Rashicën gjatë këtij afati kalimtar. Klubi gjerman thuhet se ka ulur edhe çmimin për sulmuesin kosovar, vetëm për ta shitur gjatë këtij afati kalimtar të janarit. Werderi kërkonte 20 milionë euro për ta lënë të lirë Rashicën, mirëpo tani klubi gjerman do të pranojë ofertë edhe prej 15 milionë eurove. 24-vjeçari ka kontratë me Werderin deri në vitin 2022. Për Rashicën interesim kishin shprehur skuadra si Bayer Leverkuseni, Leipzigu dhe Aston Villa. Këtë sezon Rashica ka luajtur në shtatë ndeshje në Bundesliga duke dhuruar një asistim. Ai është pjesë e Werderit që nga vitit 2018-të kur u transferua nga Vitesse.

## Federata e Gjimnastikës e Kosovës të shtunën shpall sportistët e vitit 2020

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

PRISHTINË, 22 JANAR - Federata e Gjimnastikës e Kosovës (FGjK) të shtunën në orën 13:00, në ambientet e Sallës së Kuqe në pallatin e Rinisë dhe Sporteve, shpall sportistët e vitit. Në njoftimin e lëshuar për media nga kjo Federatë bëhet me dije se do të shpërblehen shumë gjimnastë dhe gjimnaste të të gjitha kategorive. Po ashtu do të shpërblehen edhe shumë klube sportive dhe persona që kanë kontribuar që sporti i gjimnastikës ta vazhdojë ngritjen e nivelit. "Kjo shtyrje e shpalljes së sportistëve të vitit është bërë për shkak të situatës pandemike dhe zbutjes së masave kundër Covidit. Ftohen mediat që ta përcjellin këtë ngjarje të organizuar nga Federata e Gjimnastikës", thuhet në njoftimin e FGjK-së.

## Muriqi: Falënderoj shokët për mbështetjen, nuk ndalem më



Romë, 22 janar - Vedat Muriqi ishte protagonist në fitoren 2-1 që arriti Lazio përballë Parmës. "Bardhekaltrit" u kualifikuan në çerekfinalet e Kupës së Italisë, aty ku do të përballen me Atalantën. Sulmuesi "dardan" goditi shtyllën në pjesën e parë teksa gjeti rrugën e rrjetës në minutën e fundit. Një realizim fantastik me kokë, por që u ndihmua edhe nga devijimi i portierit të ekipit emilian. Një zhbllokim për bomberin e Lazios, i cili foli pas sfidës për Lazio Style Channel. "Jam i lumtur për golin dhe fitoren që arritëm. Falënderoj shokët e skuadrës që më kanë mbështetur gjithmonë edhe kur goli ka munguar. Shpresoj të jem zhbllokuar me këtë gol, në mënyrë që të shënoj të tjerë të rëndësishëm për ta ndihmuar skuadrën", ka deklaruar 26-vjeçari nga Prizreni.

# KOK-u dyfishon mbështetjen për sportistët elitarë

Prishtinë, 22 janar - Bordi ekzekutiv i Komitetit Olimpik i Kosovës ka marrë një tjetër vendim që shkon ekskluzivisht në të mirë të federatave dhe sportistëve elitarë. BE i KOK-ut ka vendosur ta dyfishojë mbështetjen për 20 sportistët elitarë të cilët ndodhen në listën e marrjes së bursave olimpike për Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Sportistët vijnë nga sportet e xhudos, boksit, mundjes, karatesë, atletikës, notit, shenjëtarisë dhe shigjetarisë. Deri në vitin e kaluar 2020, varësisht nga kategoria në të cilën ndodhen, sportistët kanë pasur mundësi që brenda një viti të përgatiten në kampe jashtë vendit, shpenzimet e të cilave i ka mbuluar KOK-u. "Sportistët që ndodheshin në




kategorinë A i kanë pasur nga 80 ditë përgatitje brenda vitit, kategoria B nga 40 ditë, ndërsa kategoria C nga 20 ditë. 80-ditëshin e kanë arritur vetëm xhudistet Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi e Nora Gjakova. Me vendimin e ri të BE-së sportistëve u është dyfishuar mbështetja, duke ua mundësuar që për të gjitha këto ditë (80, 40 dhe 20) t'u hiqen shpenzimet për gjashtë muajt e parë të këtij viti, që i bie deri në muajin kur nisin Lojërat Olimpike 'Tokio 2020', të cilat mbahen më 23 korrik-21 gusht 2021", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Po ashtu, mbështetja vlen edhe për kampet që organizohen në Kosovë dhe rajon, për kohën sa zgjat pandemia Covid-19. Krahas kësaj, BE i KOK-ut ka vendosur që brenda këtyre gjashtë muajve, sa për ta arritur normën olimpike "Tokio 2020", t'ua mundësojë heqjen e shpenzimeve sportistëve elitarë në njërën nga garat, e vlefshme për pikë olimpike "Tokio 2020". Në ditët e ardhshme do të publikohet edhe vendimi për bursistët olimpikë për Lojërat Olimpike Dimërore "Pekin 2022".

# Lakersat u rikthehen fitoreve, shkëlqen LeBroni

Los Angeles, 22 janar - Tri ditë pas humbjes së dhimbshme ndaj Golden State Warriorsit në "Staples Center", ekipi i Los Angeles Lakersit u rikthye shpejt në rrugën e fitoreve, duke mundur me shtatë pikë brenda në "Wisconsin" Milwaukee Bucks. Ditën e martë ekipi i drejtuar nga trajneri Frank Vogel shpërdoroi epërsinë e plot 19 pikëve, por këtë herë kampionët në fuqi nuk përsëritën më të njëjtat gabime dhe zhvilluan një ndeshje vërtet shumë të mirë ndaj një kundërshtari si Milwaukee Bucks, që konsiderohet ekipi i dytë më i fortë në gjithë Konferencën e Lindjes, pas vetëm Brooklyn Netsit. Në "Fiserv Forum" vendësit u shkëputën deri në +6, megjithatë ky ishte maksimumi që mundi të bënte ekipi i drejtuar nga trajneri Mike Budenholzer, pasi Lakersat u rikthyen për ta marrë kontrollin e ndeshjes që në fundin e pjesës së parë. "Liqenorët" shkuan në interval me avantazhin 63-57, dhe ekipi kalifornian nuk e ktheu më kokën pas, për ta mbyllur krejt takimin me fitoren 113-106. "Mbreti" James shënoi 34 pikë në 38' që qëndroi në parket. Gjithsesi, LeBroni kontribuoi gjithashtu edhe me 6 topa të rikuperuar dhe 8 asistime, ndërsa lojtari më i vlefshëm i dy sezoneve të fundit, Giannis Antetokounmpo, e përfundoi takimin me 25 pikë e 12 rebounde për Bucksin. Spikati te Lakersat edhe Caldwell-Pope me 23 pikë në 27', 21 prej të cilave nga jashtë harkut me gjuajtje për tri pikë, ndërkohë ylli tjetër i skuadrës Anthony Davisit e mbylli mbrëmjen me 18 pikë e 9 rebounde. Pavarësisht kësaj disfate të pësuar, Milwaukee kryeson Divizionin Qendror në Lindje me 9 fitore e 6




humbje, ndërsa skuadra e Indiana Pacersit ndjek me 8 fitore e 6 humbje. Lakersat morën pa humbur kohë kryesimin në Konferencën e Perëndimit me 12 fitore e 4 humbje. Kampionët në fuqi kanë bilancin më të mirë deri në këtë fazë të sezonit të rregullt, që gjithsesi nuk është pak, por tregon qartë se Lakersat janë favoritë për ta mbrojtur titullin, pavarësisht rritjes apo konfirmimit të ekipeve si Brooklyn Nets, Los Angeles Clippers e Milwaukee Bucks. Vlen të theksohet fakti që sezoni i rregullt këtë herë do të zhvillohet me 10 ndeshje më pak, pra do të përbëhet nga 72 sfida në total, sidoqoftë për momentin, kur po i afrohemi çerekut të sezonit të rregullt, kampionët në fuqi kryesojnë në Konferencën e Perëndimit me vetëm një fitore më tepër se dyshja Utah Jazz - Los Angeles Clippers, që ndjek aktualisht me 11 fitore e vetëm 4 humbje. Vetë "franchise" nga Salt Lake City u befasua fillimisht nga loja e mirë e New Orleans Pelicansit dhe Utah Jazzi e pa veten në disavantazhin e plot 16 pikëve në periodën e dytë të takimit. Gjithsesi Utah reagoi mirë dhe avantazhin e vetëm në 12' e dytë të ndeshjes Jazz e siguroi pikërisht në fundin e pjesës së parë, për të shkuar në interval me epërsinë minimale 70-69. Në vazhdim në Vivint Smart Home Arena, përpara 1 932 spektatorëve, Utah kontrolloi me qetësi takimin, për ta fituar gjithë ndeshjen me rezultatin 129-118. Lojtari më i mirë i takimit ishte Donovan Mitchell me 36 pikë të realizuara në 34' lojë, ndërsa në krahun tjetër spikati si zakonisht 20-vjeçari tepër i talentuar nga Karolina e Veriut, Zion Williamson, me 27 pikë, sakaq lojtari i qendrës i Jazzit, francezi Rudy Gobert, kontribuoi me vetëm 12 pikë e 11 rebounde në diçka më pak se gjysmë ore lojë.

Ditën e martë Golden State ua përmbysi kampionëve në fuqi disavantazhin e plot 14 pikëve pikërisht në periodën e fundit, megjithatë në ndeshjen e radhës Warriorsi u thye brenda në shtëpi me 15 pikë diferencë nga New York Knicksi. Në San Francisco, në "Chase Center", vendësit kryesuan në fillim 8-7. Sidoqoftë, ky ishte edhe avantazhi i fundit për skuadrën e drejtuar nga trajneri Steve Kerr. Miqtë dominuan takimin deri në fund për ta mbyllur përfundimisht takimin me fitoren 119-104. Fitorja e tretë rresht për ekipin e drejtuar nga trajneri Tom Thibodeau, që tani numëron 8 fitore dhe 8 humbje në Divizionin e Atlantikut, ku gjithsesi rivaliteti është vërtet shumë i madh me 76ers, Celticsi apo dhe Netsi. Steph Curry ishte përsëri pikëshënuesi më i mirë i mbrëmjes me 30 pikë në 35' lojë, ndërsa në krahun tjetër ra në sy 20-vjeçari kanadez RJ Barrett që realizoi 28 pikë.

SHKURT

### Brandon Waltersi, MVP i xhiros së 16

Peja ka mundur Rahovecin me shifrat 90:85 në derbin e xhiros së 16 të Superligës së Kosovës në basketboll që është zhvilluar në fundjavë. Lojtari më i dalluar në parket ishte Brandon Walters i Pejës me 24 pikë, 15 kërcime dhe një asistim, kurse kishte indeksin e lojës 37. Brandon Walters, lojtar në qendër, ka zhvilluar disa ndeshje shumë të mira që nga transferimi në 'Karagaçi', kurse kjo është hera e parë që zgjidhet MVP i xhiros. Ndërsa pesë lojtarët me indeksin më të lartë në xhiron e 16 ishin: Christopher Hortman i Vëllaznimit 37, Brandon Walters i Pejës 37, Endrit Hysenagolli i Bashkimit 34, Marvin Jones i Rahovecit 33 dhe Daniel Lekndreaj i Sigal Prishtinës 30.

### Zidane infektohet me Covid

Lajm i keq për Realin e Madridit: Zinedine Zidane ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Këtë lajm e ka publikuar vetë klubi madrilen, pasi nëpërmjet një komunikate në sajtin zyrtar i ka bërë me dije opinionit publik se tekniku francez është infektuar nga Covid-19. "Real Madridi komunikon se trajneri Zinedine Zidane ka rezultuar pozitiv me Covid-19", thuhet në njoftimin e klubit madrilen. Nuk dihet ende se ku është infektuar Zidane, por skuadra "merenguese" do t'i nënshtrohet kontrollit të tamponëve pas infektimit të teknikut të tyre.

### Tri klube në garë për Hulkun

Një betejë e fortë në merkato po zhvillohet për t'i siguruar shërbimet e brazilianit Hulk. Sulmuesi tashmë është lojtar i lirë pas mbylljes së kontratës me Shanghai Sipg, dhe prej kohësh përflitej për një rikthim në vendlindje, por ofertat e rëndësishme mund t'ia ndryshojnë planet. Dy ish-ekipet e tij në Evropë, Porto dhe Zeniti, i kanë paraqitur oferta konkrete, teksa Al Hilal në Arabinë Saudite po bisedon me agjentin e 34-vjeçarit. Me oferta të tilla vështirë që Hulku të pranojë të luajë me Flamengon, Palmeiras apo Atletico Mineiron në Brazil.

### Organizatorët: Gara në Melburn nuk bën të dështojë

Organizatorët e garës së Australisë në Formula 1 u shprehën se shtyrja e garës nga marsi për në nëntor për shkak të pandemisë Covid-19 ishte e detyrueshme për të mos e anuluar sërish këtë garë ashtu sikurse ndodhi vjet. Anulimi i asaj gare (Melburn 2020), vetëm pak orë para fillimit të provave zyrtare, ishte një goditje e rëndë financiare dhe morale për organizatorët. "Kishim investuar 25 milionë euro për atë garë dhe të gjitha ato para u dogjën. Mund të themi se anulimi i garës së vjetshme në Australi na solli një humbje 25 milionë euro. Ne nuk dëshirojmë një tjetër dështim, ndaj vendosëm ta shtyjmë garën për në nëntor, e që shpresojmë që situata të jetë më e mirë", thanë organizatorët e garës së Australisë.

AGJENCIA PËR INVESTIME DHE PËRKRAHJEN E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË KIESA

## Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

**Thirrje publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM**

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese, shpallim thirrje të hapur për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen e makinerisë prodhuese/përpunuese.
MTI/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet sipas kategorive të tyre, si në vijim:

- Për ndërmarrjet mikro (të punësuar 1 deri 9 punëtor), vlera totale e granateve do te jetë 250,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje mikro është deri në 75% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 15,000.00 EURO;
- Për ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtor), vlera totale e granateve do të jetë 150,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e vogël është deri në 50% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 30,000.00 EURO;
- Për ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtor), vlera totale e granateve do te jetë 100,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e mesme është deri në 50 % e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 50,000.00 EURO.

Aplikuesi i cili aplikon për subvencione dhe transfere në Ministri, duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

1. Për të aplikuar duhet plotësuar Aplikacionin (*shkarko në web*) me të dhënat bazike të subjektit aplikues dhe duhet të dorëzoj dokumentacionin sipas UA (MTI) 01/2018 dhe kërkesave shtesë, si në vijim:
   1.1. Deklaratën nën betim *(shkarko në web)*
   1.2. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
   1.3. Certifikatën e numrit fiskale (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë);
   1.4. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
   1.5. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi;
   1.6. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjygjësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
   1.7. Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
   1.8. Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
   1.9. Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit;
   1.10. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar më deklaratën nën betim);
   1.11. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MTI për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratën nën betim);
   1.12. Lista e të punësuarve të dëshmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2020. Në bazë të së cilës listë do të kategorizohen si ndërmarrje mikro, e vogël dhe e mesme. Sqarim: kompanitë që kanë mbi 249 punëtor, diskualifikohen.
   1.13. Ndërmarrja me rastin e aplikimit duhet të dorëzojë ofertën për blerjen e makinerisë prodhuese/përpunuese.
   1.14. Vlera e bashkëfinancimit të vlerës së projektit investiv duhet të dëshmohet me dëshmi bankare (gjendja bankare e nënshkruar dhe e vulosur) apo me "letër referencë" nga banka (nënshkruar dhe vulosur), e cila dëshmon që do të bashkëfinancoj projektin e subjektit aplikues në rast që do të përfitoj subvencionimin në fjalë.

***Sqarim: Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar me lartë, subjektet aplikuese do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e vlerësimit të listuara më poshtë.***

2. Kriteret e vlerësimit:

2.1 Të ardhurat bruto vjetore, marrin maksimum 20 pikë:
- ndërmarrjet mikro marrin nga një (1) pikë për çdo 2,000.00 EUR të ardhura bruto vjetore,
- ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 40,000.00 EUR të ardhura bruto,
- ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 200,000.00 EUR të ardhura bruto.

Të ardhurat bruto të dëshmohen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2020.

2.2 Vlera e bashkëfinancimit të vlerës së projektit investiv nga ana e ndërmarrjes (blerjes se makinerisë prodhuese/përpunuese), marrin maksimum 25 pikë:
- ndërmarrjet mikro marrin nga tri (3) pikë për çdo 1,000.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit,
- ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 1,200.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit,
- ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 2,000.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit.

2.3 Planifikimi i punësimit, maksimum 30 pikë,
- ndërmarrjet mikro marrin nga gjashtë (6) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;
- ndërmarrjet e vogla marrin nga katër(4) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;
- ndërmarrjet e mesme marrin nga dy (2) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;

Numri që planifikohet të punësohet duhet të dëshmohet me deklaratë me shkrim (nënshkruar dhe vulosur), e cila më pastaj për ndërmarrjet përfituese do të jetë pjesë e marrëveshjes.

2.4 Përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore nga gjithsej të punësuarit e subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë, nga një (1) pikë për çdo 10% te të punësuarve të gjinisë femërore. Lista e të punësuarve të dëshmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2020.

2.5 Maksimumi 15 pikë, me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet e ndara do të ndikojnë në:
- Rritjen e investimeve në Republikën e Kosovës;
- Rritjen e prodhimtarisë vendore;
- Rritjen e eksportit;
- Promovimin e turizmit;
- Zhvillimin e NMVM-ve;
- Rritjen e kapaciteteve konkuruese të NMVM-ve;
- Hapjen e vendeve të reja të punës.

*Vëmendje:*
- ✓ Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MTI/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklarimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- ✓ TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje jo deklaruese të TVSH-së. Për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- ✓ Makineria prodhuese/përpunuese e cila kërkohet të subvencionohet duhet të jetë e re.
- ✓ Ndërmarrjet mund të përfitojnë vetëm një grant dhe atë vetëm për makineri.
- ✓ Vlerësimi i aplikacioneve zhvillohet ndërmjet kategorive përkatëse si mikro me mikro, të vogla me të vogla dhe të mesmet me të mesme.
- ✓ Ndërmarrjet që nuk i kalojnë 50 pikë do të diskualifikohen.
- ✓ Përfitues do të jenë ato ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.

**Sqarim:** NMVM-të që kanë përfituar subvencionim me mjete financiare për blerjen e makinerive gjatë vitit 2019 dhe 2020 nga MTI/KIESA nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje.

**Periudha e aplikimit:**
Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mti.rks-gov.net dhe KIESA-s kiesa.rks-gov.net. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në zyrën e arkivit të Ministrisë në formë fizike dhe në CD, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Rr. Muharrem Fejza, Lagjja e Spitalit, p. n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.
Afati i fundit për shprehje të interesit është deri më datë 12.02.2021 në orën 16:00 dhe aplikimet pas këtij orari nuk pranohen nga zyra e Arkivit të Ministrisë.

Informata dhe sqarime shtesë mund të merren përmes postës elektronike në: info.kiesa@rks-gov.net konform U.A.01/2018, por jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes se thirrjes publike.

K.R.U GJAKOVA 1983

## Kompania Rajonale e Ujësjellësit

**Regional Water Supply Company**
**Regionalna vodovodna kompanija**

**KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLESIT KRU 'GJAKOVA' Sh.A. –GJAKOVE**

*Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Drejtorëve me rregulloren për marrjen dhe dhënien me qira të objekteve të KRU'Gjakova'SH.A-Gjakove Shfrytëzimi i hapësirave do te bëhet me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira, për të krijuar të hyra duke ofruar me qira hapësirat e lira nëpër objekte Bazuar në rregulloret e brendshme dhe Ligjet në fuqi KRU "GJAKOVA Sh A.Gjakove, nxjerr këtë:*

**FTESË PËR OFERTIM PËR DHENIE ME QERA PARCELES me siperfaqe prej 1252 m2**

***Kushtet e KRU "Gjakova" sh.a.***

*Parcela e cila ofertohet për qiradhënie eshte ne siperfaqe prej 1 252 m2*

*Hapësira që do të lëshohet me qira, do t'i dorëzohet qiramarrësit sipas gjendjes ekzistuese.*

*Hapesira nuk mund te shfrytezohet per ndertim te vrazhdë.*

*Ofertuesi do te jetë pergjegjes për mirembjatjen e hapësirës përreth dhe obligohet të adaptojë një parking per 6 vetura per nevoja te Kompanise.*

*Afati kohor i dhenies me qera ne kohezgjatje prej 3 vite.*

***KRITERET E KRU'Gjakova"sh.a-Gjakove***

*Te drejte pjesemarrje kane si personat fizik dhe juridik.*

*Persona fizik duhet te kene kopjen e leternjoftimit , vertetimin nga Gjykata qe nuk jane ne hetime*

*Peronat juridik duhet te sjellin certifikaten e regjsitrimit te biznesit kurse vertetimi nga Gjykata ne emer te Operatorit ekonomik se nuk eshte ne hetime.*

***INFORMATA ADMINISTRATIVE***

- *Komision i themeluar nga KRU'Gjakova' sh.a., do të bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertes më të mire dhe më të favorshme.*
- *Vlera fillestare e dhënies me qera te parceles fillon prej 300 Euro*
- *Obligimet tatimore me rastin e dhenies se parceles me qera zbriten sipas Ligjeve ne fuqi, Qiramarresi zbret nga qiraja qdo ndalese tatimore qe kerkohet me Ligj ne emer te qiradhenesit dhe qiramarresi ja siguron qiradhenesit nje certifikate vjetore te ndalesave tatimore.*
- *Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura.*

  *Afati për dorëzimin e ofertave: është deri me datën 05.02.2021 në ora 16:00.*
- *Vendi i dorëzimit, arkiva e KRU"Gjakova sh.a. Gjakova rr. UÇK nr 7 50000 Gjakove.nr tel 039032050.*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada - Government***
*Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

U cilju smanjenja trgovinskog deficita i poboljšanja

(KIESA) najavljuje:

**Javni poziv za subvencije finansijskim sredstvima za MMSP**

Na osnovu Administrativnog Uputstva (MTI) br. 01/2018 o Raspodelu Finansijskih Sredstava od Ekonomske Kategorije Subvencija i Transfera, i
/prerađivačkih
mašina.

MTI/KIESA
kategorijama, kako sledi:

- (zaposlenih 1 do 9 radnika) ukupna vred 250 000,00 EVRA imati koristi je do 75% od vrednosti mašine ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 15.000,00 EVRA;
- ( 50% vrednosti mašine ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 30.000,00 EVRA;
- (zaposle 50% vrednosti mašine ili u finansijskoj vrednosti maksimalno do 50.000,00 EVRA.

Podnosilac aplikacije koji se prijavljaju za subvencije i transfere u Ministarstvu, moraju biti registrovani u Republici Kosovo.

1. Da biste aplicirali, treba ispuniti Aplikaciju (preuzmite na vebu) sa osnovnim podacima aplikanta i treba dostaviti dokumentaciju prema AU (MTI) 01/2018 i dodatnim zahtevima, kao što sledi:
   1.1. Izjava pod zakletvom (preuzmite na vebu)

   1.2.Sertifikat o registraciji poslovanja sa svim pratećim informacijama u skladu sa zahtevima važećeg zakonodavstva u Republici Kosovo;
   1.3.Sertifikat o fiskalnom broju (ne važi za preduzeća koja broj registracije poslovanja i fiskalni broj imaju u jednom Sertifikatu);
   1.4.Poreska potvrda kojom se potvrđuje da podnosilac aplikacije trenutno nema neizmirenih poreskih dugova ili druge poreske obaveze, ili je sa PAK-om zaključio sporazum o izmirenju duga;
   1.5.Kopiju lične karte lica na čije ime je podnosilac aplikacije registrovan;

   1.6.Uverenje od podnosioca aplikacije da nije u stečaju ili pod prinudnom sudskom upravom, izdatu od strane Osnovnog Suda traži se original, ne stariji od 30 dana;
   1.7.Dokaz o aktivnom računu podnosioca aplikacije u jednoj od licenciranih banaka od strane Centralne Banke Kosova;
   1.8.Stanje na bankovnom računu podnosioca aplikacije za poslednju godinu. Za novoosnovane podnosioce aplikacije ovo nije primenjivo;
   1.9.Nacrt predloga koji obuhvata: svrhu, aktivnosti projekta, finansijske troškove i vremenski rok za realizaciju projekta, kao i organizacionu strukturu podnosioca aplikacije;
   1.10.Da nije primio sredstva iz drugih izvora finansiranja za iste aktivnosti (potvrđuje se davanjem izjave pod zakletvom);
   1.11.Da su ispunili sve obaveze iz prethodne finansijske podrške, ako su ostvarili korist iz javnih izvora finansiranja MTI-a u poslednje dve godine, (potvrđuje se davanjem izjave pod zakletvom);
   1.12.Lista zaposlenih koju treba da overi Poreska Administracija Kosova za 2020. Na osnovu koje liste biće kategorisana kao mikro, mala i srednja preduzeća.
   Pojašnjenje: Kompanije sa više od 249 zaposlenih su diskvalifikovane.
   1.13.Prilikom podnošenja zahteva, preduzeće mora podneti ponudu za kupovinu mašine za proizvodnju/preradu.
   1.14. Vrednost kofinansiranja vrednosti investicionog projekta mora biti dokazana bankarskim dokazima (bankovni bilans sa potpisom i pečatom) ili "referentnim pismom" banke (potpisano i pečatom), što dokazuje da će kofinansirati projekat podnosioca aplikacije u slučaju primanja dotične subvencije.

***Pojašnjenje: Molimo obratite pažnju da u nedostatku bilo kog od gore zahtevanih dokumenata, podnosioci aplikacije će biti diskvalifikovani i neće biti dalje razmatrani za dole navedene kriterijume za ocenjivanje.***

2. Kriterijumi ocenjivanja:

2.1 Bruto godišnji prihod, dobijaju maksimalno 20 poena:
- mikro preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 2.000,00 EVRA bruto godišnjeg prihoda,
- mala preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 40,000.00 EVRA bruto prihoda,
- srednja preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 200,000.00 EVRA bruto prihoda.

Bruto prihode treba da dokaže Poreska Administracija Kosova za 2020 godinu.

2.2 Vrednost kofinansiranja vrednosti investicionog projekta od strane preduzeća (kupovina proizvodnih/prerađivačkih mašina), dobijaju maksimalno 25 poena:
- mikro preduzeća dobijaju po tri (3) poena za svakih 1.000,00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta,
- mala preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 1.200,00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta,
- srednja preduzeća dobijaju po jedan (1) poen za svakih 2,000.00 EVRA izjave o kofinansiranju vrednosti projekta.

2.3 Planiranje zapošljavanja, maksimalno 30 poena,
- mikro preduzeća dobijaju šest (6) poena za jednog (1) kojeg će zaposliti;
- mala preduzeća dobijaju po četiri (4) poena za jednog (1) kojeg će zaposliti;
- srednja preduzeća dobijaju po dva (2) poen za jednog (1) kojeg će zaposliti;

Broj koji se planira zaposliti mora se dokazivati pismenom izjavom (potpisanom i pečatom), koja će zatim biti deo sporazuma za preduzeća koja su korisnice.

2.4 Procenat zaposlenih žena od ukupnog broja zaposlenih podnosioca aplikacije, maksimalno deset (10) poena, po jedan (1) poen na svakih 10% zaposlenih žena.
Lista zaposlenih koju treba da overi Poreska Administracija Kosova za 2020.

2.5 Maksimalno 15 poena, sa projektnim predlozima koji dokazuju da će dodeljene subvencije uticati na:
- Povećanje investicija u Republici Kosovo;
- Povećanje domaće proizvodnje;
- Povećanje izvoza;
- Promovisanje turizma;
- Razvoj MMSP-a;
- Povećanje konkurentnih kapaciteta MMSP-a;
- Otvaranje novih radnih mesta.

*Pažnja:*
- ✓ U slučaju da će preduzeće biti korisnik, onda će biti potpisan bilateralni sporazum (MTI/KIESA i preduzeće), deo svakog od njih će biti izjave date prilikom apliciranja.
- ✓ PDV je prihvatljiv trošak samo za fizička lica i preduzeća koja nisu deklarativna za PDV. Za preduzeća koja su deklarativna za PDV, to je neprihvatljiv trošak.
- ✓ Mašine za proizvodnju/preradu za koje se zahteva subvencioniranje moraju biti nove.
- ✓ Preduzeća mogu dobiti samo jedan grant i to samo za mašine.
- ✓ Ocenjivanje aplikacije odvija se između odgovarajućih kategorija kao što su mikro sa mikro, mala sa malim i srednja sa srednjim.
- ✓ Preduzeća koja ne pređu 50 poena biće diskvalifikovana.
- ✓ Korisnici će biti preduzeća koja ocenjivačka komisija ocenjuje sa najviše poena, zavisno od planiranih budžetskih ograničenja.

**Pojašnjenje:** MMSP koja su koristila subvencije finansijskim sredstvima za kupovinu mašina tokom 2019 i 2020 godine od strane MTI/KIESA nemaju pravo na korišćenje ovog poziva.

**Period apliciranja:**

Saopštenje za javni poziv objavljeno je na veb stranici Ministarstva Trgovine i Industrije mti.rks-gov.net i KIESA kiesa.rks-gov.net. Subjekti koji se žele prijaviti na javni poziv treba da iskažu svoje interesovanje podnoseći svu dokumentaciju u arhivu Ministarstva u fizičkom obliku i na CD-u, u Ministarstvu Trgovine i Industrije, Ul. Muharrem Fejza, bb.Bolničko Naselje, Priština, 10000, Republika Kosovo.
Zadnji rok za iskazivanje interesa je do 12.02.2021 u 16:00, a prijave nakon tog roka neće biti prihvaćene od Arhiva Ministarstva.
Dodatne informacije i pojašnjenja mogu se dobiti putem e-maila na: info.kiesa@rks-gov.net u skladu sa A.U. 01/2018, ali ne kasnije od pet (5) dana pre završetka javnog poziva.






REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 208/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Doruntina Kurtolli-Reshani, nga Ferizaj, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Abit Asllani, avokat nga Prishtina, Rruga, "Luan Haradinaj" p.n, kundër të paditurit Egzon Kurtolli, nga Prishtina, Rruga, "Xhemë Gostivari", p.n, tani me adresë të pa njohur, për zgjidhjen e martesës, jashtë seance me datë 18.12.2020, merr këtë:

AKTVENDIM

Të paditurit Egzon Kurtolli, i CAKTOHET përfaqësuesja e përkohshëm, Arta Mazreku, avokate nga Prishtina.

Përfaqësuesja e përkohshme i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktojnë të autorizuarin e tij, apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë - Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, t'i caktoj kujdestarin.

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.

Ky aktvendim do të publikohet në mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, Gazetën Zyrtare, po ashtu i dorëzohet përfaqësueses së përkohshme të autorizuarit të paditësit dhe Organit të Kujdestarisë.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.208/18, dt. 18.12.2020

KËSHILLË JURIDIKE:
kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Gjyqtari
Ylber Shurdhiqi

---

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 4265/20 të datës 24.09.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

---




---

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Jashar Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Xhemile Halimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI-IX shfmu "Mati Llogoreci" Prizren.

▶ Hidajete Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl. V dhe VI-IX shfmu" Dy Dëshmorët" Pirane.

▶ Samir Ibishi shpall të pavlefshme dëftesat e SHMLM "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

▶ Gazmend Kosumi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12,13 të SHMLT "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

▶ Hysnije Perçuku shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit 3,4 të Shmlm "Dr Xheladin Deda"

▶ Zeqir Musa shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani"

▶ Hana Shala shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abdullah Shabani"

▶ Muhamet Behrami shpalle te pavlefshme dëftesën e shkolles fillore "Azem Bejta"

▶ Veli Cimili shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Trepca"

▶ Nuradin Nebihu shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 810349945

▶ Daut Mustafa shpalle te pavlefshme dëftesën e vitit X te Shmlt "Arkitekt Sinani"

▶ Qendrim Hoti shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymber Kelmendi**

***

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

***

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve te shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

***

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

***

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

ISBN 978-9951-780-37-7

**ÇMIMI: 5.99 €**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLOWSKI

ARMAGEDONI



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.
*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

ISBN 978-9951-780-10-0

4 99 €

Daut Dauti • NJË PALË KËPUCË NË BERLIN



Daut Dauti

NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

*novelë*

ARMAGEDONI


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola